



KOMUNA E RAHOVECIT
OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
ANEKS KONTRATA

Numri i kontratës:¹ 623-25-4246-5-2-5/C674

Numri i Brendshëm: 623-21-2485-5-1-1/5-1

KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik: FIDANI L SH.P.K.; FIDANI-BETON SH.P.K.; Company Murseli SH.P.K.; COMPANY BEJTA COMMERCE SH.A., Rr. Arben Qerimaj, Nr 180, Deçan, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin Aneks Kontratë për punë e shënuara me poshtë:

Titulli i Aneks Kontratës: **RREGULLIMI I KANALEVE TË KULLIMIT TË TOKAVE BUJQËSORE**

Lot 1 – NDËRTIMI I KANALIT TË TOKAVE NGA SHTAVICA DERI NE FORTESË

Me numër identifikues: 623-25-4246-5-2-5



- I. Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të përmendura më lartë kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e punëve për projektin: **RREGULLIMI I KANALEVE TË KULLIMIT TË TOKAVE BUJQËSORE – Lot 1–NDËRTIMI I KANALIT TË TOKAVE NGA SHTAVICA DERI NE FORTESË**, me Numër të kontratës: 623-21-2485-5-1-1/C298, të datës: 25.08.2021, e cila kontratë është në realizim e sipër.
- II. Duke u bazuar në kërkesën për punë shtesë nga Menaxheri i Projektit dhe arsyetimet për mospërfshirjen e punëve shtesë në kontratën bazë, në Njoftimin për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, në vendimin mbi aprovimin e punëve shtesë të kontratës dhe kryerjen e suksesshme të punëve për: **RREGULLIMI I KANALEVE TË KULLIMIT TË TOKAVE BUJQËSORE – Lot 1–NDËRTIMI I KANALIT TË TOKAVE NGA SHTAVICA DERI NE FORTESË**, Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi pajtohen që të lidhin aneks kontratë për kryerjen e punëve shtesë sipas ofertës së datës: 26.05.2025, me kushte të njëjta si në kontratën bazë.
- III. Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit, ndërsa ekzekutimi i punëve duhen të përfundohen në afat jo më të gjatë se: **10 ditë pune** pas fillimit të ekzekutimit të Punëve.

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:

- I. Kontrata bazë që është duke u përmbushur, është vazhduar edhe për kryerjen e punëve shtesë të pa parashikuara si marrëveshje reciproke në mes palëve.
- II. Çmimi i punëve shtesë është gjithsej: **190,641.15 Euro;**
(Një qind e nëntë dhjetë mijë e gjashtëqind e katërdhjetë e një Euro e pesëmdhjetë Cent)
Sipas përshkrimeve të punëve dhe sasive të dhëna në Dosjen e tenderit numër: **623-25-4246-5-2-5 & 623-21-2485-5-1-1/5-1**
- III. Punët shtesë kontraktohen bazuar në përshkrimin e punëve shtesë të Menaxherëve të Projektit, Njoftimit në KRPP dhe kushteve të negocuara në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit që janë pjesë e këtij Aneksi të Kontratës.
- IV. Pagesa e punëve shtesë do të bëhet në bazë të konstatimit të Personave të Autorizuar të Autoritetit Kontraktues pas perfundimit të punëve.
- V. Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
 - a. Marrëveshja e kontratës;
 - b. Përshkrimi i punëve shtesë nga Menaxherët e projektit që duhet të realizohen;
 - c. Njoftimi në KRPP për punët shtesë.
- VI. Të gjitha kushtet tjera të kontratës bazë mbesin të njëjta.

Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën: Shqipe² në tri origjinale, Dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:		Për Kontraktuesin:	
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Lulzim Beqiraj
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	29.05.2025	Data:	29.05.2025
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNIMEVE SHITESË
NDËRTIMI I KANALIT TË KULLIMIT DHE KOLEKTORIT NGA RAHOVECI DERI NË FORTESE

A					
2	PUNËT E DHEUT, ZHAVORIT DHE GJEOTEKSTILIT				
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Totali (€)
2.1	Gërmimi i dheut (baltës) në fundin e lumit dhe gërmimi i humusit në brigjet e lumit. Në çmim të llogaritet transportimi deri në deponin e përcaktuar nga Organi mbikqyrës në largësi deri në 15Km.	m³	3,805.00	42.46	161,560.30
TOTALI POSICIONI:2					161,560.30
A					
Nr.	REKAPITULLIM: RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT - PUNIMET SHITESË				
2	PËRSHKRIMI I POZICIONIT				SHUMA TOTALE
	PUNËT E DHEUT, ZHAVORIT DHE GJEOTEKSTILIT				161,560.30
	GJITHËSEJ PA TVSH :				161,560.30
	TVSH(18%) :				29,080.85
	GJITHËSEJ ME TVSH :				190,641.15



Handwritten signature in blue ink.